



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 24.08.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 29 datë 29.06.2026 për dënimin me gjobë, të shoqërisë “Tring Tv” sh.a., autorizuar për subjektin OSHMA “Tring Tv”. **(Vendimi nr. 92, datë 24.08.2026)**
2. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik “Preng Doda”, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Besëlidhja”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendimi nr. 93, datë 24.08.2026)**
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë të shoqërisë “Korabi-Net” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Korabi Net”. **(Vendimi nr. 94, datë 24.08.2026)**
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Click.al” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Click.al”, për reduktimin e zonës së ofrimit të subjektit. **(Vendimi nr. 95, datë 24.08.2026)**
5. Pranimin e kërkesës së ish-subjektit “Era-Digital” sh.p.k. për rishikimin dhe ndryshimin e pjesshëm të Vendimit nr. 13, datë 17.02.2025. **(Vendimi nr. 96, datë 24.08.2026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 24 Gusht 2026